



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 125, datë 05.09.2012

PËR
MIRATIMIN E PROSPEKTIT TË NDRYSHUAR TË FONDIT TË INVESTIMIT
“RAIFFEISEN PRESTIGJ”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6, germa a) të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 75, pika 2, të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

KONSTATOI SE:

Shoqëria “Raiffeisen Invest” shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë të datës 05.07.2012 ka paraqitur në AMF prospektin e ndryshuar të Fondit të Investimit “Raiffeisen Prestigj”.

Pjesa më e madhe e ndryshimeve të prospektit nuk përbën ndryshime thelbësore në kuptim të pikës 1 dhe 2 të nenit 76 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Ndër ndryshimet e propozuara në prospekt, ndryshimi i maturitetit mesatar të kthimit të investimit (average duration) nga 1 në 5 do të thotë risk më i lartë për portofolin e fondit të investimit dhe kryesisht riskut që lidhet me ndryshimin e normave të interesit.

Në pikën 1/b të nenit 76 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” parashikohet si ndryshim thelbësor edhe rasti i ndryshimit të risqeve që lidhen me investimet e parashikuara të fondit të investimit.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I :

1. Miratimin e prospektit të ndryshuar të fondit të investimit “Raiffeisen Prestigj”, nën administrimin e shoqërisë “Raiffeisen Invest” sh.a., shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet departamenti përkatës për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI